



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 21.12.2018

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 19.12.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "V.Z company" për aktivitetin: "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik LOT 1**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-025-211 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "VZ Company" e datës 19.12.2018 lidhur me aktivitetin e prokurimit " **Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik LOT 1**" me Nr. 616 18 440 211 Nr. Brendshëm : 616 -18-025-211 kundër *vendimit per dhënie të kontratës* te AK –së, të datës 10.12.2018 te publikuara ne web-faqe te KRPP-së.
2. Anullohet *njoftimi* i publikuar me datë: 10.12.2018 .
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te kete aktivitet ta kthej ne rivleresim*.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "VZ Company" me datë 19.12.2018 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik LOT 1**" me numër të prokurimit Nr. 616 18 440 211 dhe numër të brendshëm 616 18 025 211.


Autoriteti Kontraktues, me datë 21.12.2018, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

1.Lidhur me pretendimet per piken 1,6 dhe 11 kemi konstatuar se eshte i bazuar pretendimi per tre kamionat te cilet bejne pastrimin e rrugeve nga bora me targa 03-107-FJ , 03-226-ES dhe kamioni Sauerberna-2DM/2VM , nr i shasise 202891/872 te cilet sipas deshmive te ofruara ne tenderin e OE-ik Ve Mor jane te cregjistruara .
Pretendimi per pronarin e paisjeve eshte e paqendrueshme pasi qe AK ka kekruar sqarime me kete dhe eshte pranuar konfirmimi nga qendra e regjistrimit te bizneseve mbi ndryshimin e emertimit te kompanise nga Plastelin Ve Mor ne Ve Mor SHPK.
Pretendimi tjetër për mungesën e deshmive për autocisternen Mercedes –Benz 1622 është i bazuar pasi që mungon deshmia e kërkuar .

Bazuar ne kete komisioni i rivleresimit duhet te analizoj me kujdes listen e paisjeve te ofrura dhe deshmite e tyre

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit